

GJAMA E BURRAVE - TIPAR I ARDHUR NGA NJERIU PARAK (NJERIU I NATYRËS)

Sazan **GURI**, Gjok **DUKGILJA**

Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Gjama e burrave është një traditë e lashtë që ka përcjell popullin shqiptar për disa shekuj në veçanti në Veri të Shqipërisë. Megjithatë, kjo traditë ka nisur të zhduket dhe të vetmit që po e mbajnë gjallë janë pleqtë e këtyre vendeve veriore. Gjamën e burrave e vajin e grave na e ka përshkruar me hollësi Frongo Bardhi në shkrimet e tij. Ai thotë se: Këta shqiptarë i quajnë me gjithë zemër njerëzit e gjakut të vet në çastin e vdekjes¹. Të gjithë shkyhen rrobash, burrat gërvishin fytyrën me thonj deri sa të rrjedhë gjaku, dhe presin mjekrën e nuk rruhen në shenjë trishtimi të madh dhe gratë shkurtojnë flokët e rrahin gjokset, kështu që disa herë me vështirësi lejojnë të bëhen funksionet (shërbimet fetare) nga britmat e përlotshme.

Fjalë kyçe: gjama, njeriu parak, traditë, vajtje, rit, zakone

ABSTRACT

The gjama of men is an ancient tradition that has followed the Albanian people for several centuries, especially in the North of Albania. However, this tradition has begun to disappear and the only ones who are keeping it alive are the elders of these northern countries. Frongo Bardhi has described the plight of men and the oil of women in detail in his writings. He says: These Albanians wholeheartedly call people of their own blood at the moment of death. Everyone tore clothes, men scratch their faces with fingernails until blood flows, and cut their beards and do not shave as a sign of great sadness and women cut their hair short and beat their breasts, so that sometimes with difficulty they allow functions (religious services) to be performed by tearful cries.

Key word: gjama, primitive man, tradition, lamentation, ritual, mores

HYRJE

Vaji e gjëma të bëra me tronditje të mëdha, kanë qenë praktikuar edhe në lashtësinë ilire, dëshmuar mirë te Dardanët, po kështu edhe ndër thrakë, ndër grekë e romakë. Si e tillë ajo lidhet me jetën para civilizimeve të këtyre popujve, që sikundër e vlerë sonte Budi, ato ishin britma pagane, pra të një origjine parake ose të njeriut të natyrës. Vonë vonë, ato ngelën si tipar i popujve mesdhetare e të popujve të lindjes së afërme. Le të kujtojmë rreth 4000 vjet më parë Gilgameshin, mbret i Urukut, te Sumerët indoeuropianë të Mesopotanisë, se si e vajton me gjamë e britmë Enkid ujin, mikun e tij të trimërive, se si shkul flokët e shkyen rrobat dhe porsi luani shqirret e thërret vaj, flokët i shkul, i hedh, teshat i shkyen petkun e zisë e vesh, të pluhërosur. Porsa e para rreze vesën treti, prapë Gilgameshi zhgrehet në vaj e gjamë. Gjashtë netë e ditë e qan Enkidujin, deri në agim të shtatë e më mbi dhë, të shtatën ditë ai mikun e varros pastaj braktis qytetin e Urukut".²

Gjama e burrave traditë e lashtë sa vet shqiptarët

¹ Frano Bardhi, *Fjalori Latinisht Shqip*, v. 1635

² Epii Gilgameshit, *Tiranë*, v. 1980, f. 79

Pjetër Budi këto vajtime e britma të natyrës pagane i quan: më të shëmtuarat mbi këtë dhe; kanë gjamë e vajtime e të gërvishunit e të ramit me grusht që bëhet jo mbi të vdekurit e në kishë të Tënzot, por edhe për mbi disa vetë që gjinden në fije të mortës e tue dekun", thekson ai.³ Vërehet pra këtu një ngjashmëri e madhe në gjëmë e vaje, mes asaj kohe sumere tepër të lashtë e Shqiptarëve, në këto rite tronditëse të vdekjes. Si e kanë vërejtur dijetarët e mëdhenj, të entologjisë fetare në ritet e vdekjes në popuj të ndryshëm, mes tyre edhe në popuj të iliriadë s, vërehen jo pak dukuri kozmogonike: ide e përfytyrime të krijimit fillestar, të të asgjësuarit për t'u rikrijuar (për t'u ringjallur) në botën e përtejme e në pasardhës me anë të kalimit të shpirtit nga gjenerata në gjeneratë, asgjësim e rianimizim i vazhdueshëm.⁴

Fig. – 1 Funeral i Ujk Vuksanit në theth. V. 1936 (foto nga R. Schulz)



Funerali i Ujk Vuksanit në Theth (foto: Reimer Schulz, 1937)

Këto ide në forma simbolike e të gurëzuara i vërejmë edhe në veçoritë e gjamës së Shqiptarëve që u paraqit më parë, po edhe në disa vajtime grash, shoqëruar me veprime tepër arkaike e të çuditëshme. Po këta elementë janë të cunguar e tepër të diskutueshëm në përmbajtjen e tyre mirëfilltësore.



Funerali i Ujk Vuksanit në Theth (foto: Reimer Schulz, 1937)

Fig. – 2 Një nga elementët e qarjes me gjama të burrave në funeralin e Ujk Vuksanit (foto nga R. Schulz), v. 1936

Gjama e burrave është një traditë që është përdorur nga burrat shqiptar vetëm për burrat e vdekur. Rituali mortor është përdorur në zonën e Malësisë së Madhe, Dukagjinit, Gjakovës, Iballë, Mirditë e Tropojë. Rituali nuk mund të nis, nëse të paktën nuk janë 10 burra. Sa më shumë burra që i bashkohen këtij rituali, aq më i madh është respekti për të vdekurin. Kjo traditë është përdorur me shekuj, mirëpo që kur Enver Hoxha kishte ardhur në pushtet në vitin 1945, kjo si shumë tradita të tjera

ishte e ndaluar nga pushteti.⁵

Historiani shqiptar, Pjetër Marticanaj ka thënë se kjo traditë është e lidhur ngushtë me vdekjen e Skënderbeut në shek. - XIV. Nga mërzia e inati, Princ Lekë Dukagjini kishte bërë titull me të madhe, rrihte gjoksin, ngrihte flokët dhe gërvishte fytyrën e tij. Që nga ajo kohë, ky ritual është praktikuar sa herë që një

³ Pjetër BUDI, *Rituali roman*, v. 1621.

⁴ ndër ta E. De Martino, *M Eliade*.

⁵ Fotot, si kjo dhe më poshtë janë bërë nga gjermani Raimer Shulc në Theth në vitin 1937. Fotot tregojnë se si ishte 'gjama e burrave' në atë kohë.

person i ndershëm kishte vdekur. Esenca e këtij rituali është që të lihet dhimbja të shkoj dhe të largohet nga njeriu e po ashtu edhe të respektohet i vdekuri. Këtë gjamë shumë kush nga brezi ynë e kemi ndeshur në librat e historisë së shkollës fillore dhe mendojmë se kjo ka ardhur si më e fundit por e freskët me anë të të treguarit në popullin shqiptar. Mirëpo, gjama kryhej edhe ndër shqiptarët ushtarë tej në Stamboll, veçanërisht në rreshta me plot arnaut të jenicerëve, kur në pallatin e sulltanit ndodhte një vdekje. Sigurisht mbahet mend koha nga Skënderbeu, por jo se ky ritual është shfaqur në këtë kohë, *por realisht praktika është më e vjetër dhe përshkrime të ritualeve të tilla gjenden që tek Odisea i Homerit.*

Sipas kronikanëve të kohës, kur vdiq Skënderbeu në vitin 1468, Lekë Dukagjini rrihte gjoksin e shkulte flokët, siç bëri Akili kur u vra Patrokli në luftën e Trojës, tremijë e kusur vjet më parë. Udhëtarë e misionarë të huaj të shekujve XV-XVII, që kanë studiuar dhe vërejtur këtë dukuri të malësorëve të Shqipërisë së veriut, sidomos ritet e vajtimit ndër burra, i vlerësojnë ato si të natyrës pagane e të çuditshme. Misionari Rodini, në kujtimet e tij dëshmon se burrat shqiptarë qajnë e bërtasin me të madhe më shumë se një gjysmë ore, bërtasin bashkarisht më fort nga ç'kanë bërtitur izraelitët në vendin e Hananit, ku kanë varrosur Patriakun Jakov.⁶

Në Shqipërinë e veriut, kryesisht në zonat e Nikaj Merturit, Dukagjinit, disa krahinave të Pukës, Malësisë së Mbishkodrës, Kosovës, etj, riti i gjëmës së burrave thonë se ka filluar pas vdekjes së Skënderbeut, pra rreth vitit 1468 janë kronikat e para që raportojnë këtë zakon. Tradita ka vazhduar deri në vitin 1960. Për herë të fundit në Nikaj Mërtur, gjëma e burrave është bërë në vdekjen e Malush Zeqirit nga fshati Peraj. Thuhet se oshëtima dhe britmat e gjëmatarëve kanë ushtuar deri në qafë të Kolçit. Ishte një ndër ngjarjet që shtyu sistemin komunist ta ndalojë këtë rit të veçantë, duke e konsideruar “zakon prapanik”.

Fig. - 3 Një nga elementët e qarjes me gjama të burrave në funeralin e Ujk Vuksanës (foto nga R. Schuz), v. 1936



Funerali i Ujk Vuksanit në Theth (foto: Reimer Schulz, 1937)

Pjetër Ndue Marticanaj, ish-mësues historie dhe njohës i mirë i traditave të zonës së Nikaj-Merturit konfirmon se zanafilla e këtij riti është pikërisht sjellja e Lekë Dukagjinit në vdekjen e Skënderbeut: “Princi Lekë Dukagjini nga mërzia e thellë për vdekjen e Skënderbeut, vajtoi me zë të lartë, rrahu gjoksin, shkuli flokët dhe filloi të gërvishet me thonj. Duket e habitshme, por e bërë prej Lekës, u kthye në zakon. Që andej e tutje, për çdo burrë të nderuar, duhej të kryhej i njëjti rit”, - thotë ai dhe shton: “Është një rit i organizuar. Prijësi ka detyrën që të merret me çdo detaj dhe përgjegjësinë që çdo gjë të shkojë. Zef Prend Pepkolaj, jetuar mbi 90 vjet, ka marrë pjesë shpesh në këto rite fetare. Ai vetë e ka mësuar nga gjyshi i tij që në moshë të re. Por nga vitet 50-60, riti u ndërpre nga regjimi komunist si zakon prapanik. Ka rifilluar pas viteve '90 - tregon Zefi. Mblidheshin burrat e fshatit dhe të fisit dhe nga larg e nisnin gjëmën, duke rrahur gjoksin me grushta- thotë 90 vjeçari. Prijësi më pas i afron burrat tek personi që i bëhet gjama dhe u thotë burrave që ta rrethojnë. Nëse gjëmën ia bënin nipit, thuhej: “o i mjeri nipi im”; nëse gjama i bëhej mikut, thuhej: “o i mjeri mik” - thotë ai. Teksti i

⁶ Etnologu Mark Tirta, v. 1637

kushtohet të vdekurit, virtyteve dhe cilësive të tij. Pra, një histori e shkurtër e atij burri që ikën. Nok Gjoni një nga gjamtarët më me zë në Malesinë e Madhe në qarkun e Lezhës dhe të Shkodrës tregonte që në zona të ndryshme gjama ishte e ndryshme. Ai njihte shume mirë se si zhvillohej ky rit. Por “gjama” ishte e ndryshme për krahina të ndryshme. Zona e Malësisë së Madhe edhe sot e ka të pranishme gjamën dhe e ka si në rastin kur vdes femër apo mashkull diçka që e bën më të ndryshme si traditë nga zonat që u përmendën më lart. Në rastin që është femër është po një femër gjamtare siç quhet që e kryen gjamën dhe në rastin e meshkujve është burrë. Ajo çka mund të theksohet është se kurrë një burrë nuk bën gjamë për një grua, përveç rasteve kur kjo grua ka hyrë në rangun e burrneshave, atëherë ajo vajtohet dhe nga burrat.

Si zhvillohet ky rit?

Në fazën e parë gjamatarët heqin rrobat e rënda (në kohë dimri e të ftohti), vendosin duart mbi ijet e bërrylat dhe i mbajnë hapur anash. Prijësi i gjamës, (ai zgjidhet unanimisht nga pjesëmarrësit, duke qënë më i vjetri, e më i përgatituri, jep shenjë dhe fillon lëvizja, duke u përdredhur i gjithë grupi herë majtas e herë djathtas, duke u përkulur mbi shalë e duke u ngritur, duke rrahur për tokë herë njëren këmbë e herë tjetren, duke shpërthyer në britma të gjithë përnjëherë. Pastaj të gjithë ngrejne kokën lart, e një dorë e vënë te goja e tjetren te veshi duke lëshuar ofshama dhe thërrasin emrin e të vdekurit me fuqi e duke e zgjatur zërin. Pastaj shpërthejnë me thirrje.

Në fazën e dytë ata lëshohen me hap të rëndë dhe epik drejt kufomës (përshkojnë distancë rreth 50-100 m) dhe ndalojnë të gjithë përnjëherësh. Pamja është interesante, kryet lart, kraharorzbuluar, duar në ije, me këmbë gjysmë të hapura. Pastaj gjëmtarët “ngrijnë” dhe presin shenjën e prijësit. Sapo ai bën shenjë ata lëshojnë pasthirmën “hou! “ ose “ho!”, heqin duart nga mesi, i bëjnë grusht dhe me forcë i ngrejne lart. E kështu i mbajnë derisa përfundojnë thirrjen “i mjeri unë për ty!”. Pastaj menjëherë ulin grushtat dhe i përplasnin mbi kraharorin e zbuluar. Kjo zgjat derisa gjëmtarët mbarojnë ofshamën “Ho! Ho! Ho!”

Fig. - 4 Një nga elementët e qarjes me gjama të burrave në funeralin e Ujk Vuksanit (foto nga R Schuz), v. 1936



Funerali i Ujk Vuksanit në Theth (foto: Reimer Schulz, 1937)

Në fazën e tretë, nëse mund ta quajmë kështu, me shenjë të prijësit, sulmojnë me vrap edhe 50-100 hapa drejt të vdekurit. Kur lëshojnë thirrjen e përsëritur “Ho! Ho! Ho!” heqin duart nga mesi dhe i çojnë anash te fytyra, ngulin thonjtë në tëmtha e në faqe e nisin e gervishtin fytyren derisa ju rrjedh gjaku.

Së fundi, ulen në gjunjë me radhë duke vazhduar thirjen e fundit, ulen krejt për tokë, mbështesin ballin përdhe e me duar përkëdhelin dheun. Qëndrojnë kështu deri sa një mashkull i shtëpisë apo vëllaznisë së të vdekurit, i ngarkuar për këtë punë, u shkon afër dhe i ngre, duke u thënë: “boll o burra!” dhe “Ua shpërblefshin në të mira!” ose “Paçi faqen e bardhë!”

Për zonat e rrafshit të Dukagjinit janë gjithmonë 10 burra që fillojnë që nga mesi i rrugës, duke vajtuar me shkulje flokësh, goditje gjoksit me grushte dhe çjerrje në fytyrë deri sa vijnë para vigut (ashtu quhet i vdekuri) duke i treguar gjithë historinë e tij dhe njerëzit që ka lënë me dhimbjen pas, dhe në fund i përmendin të vdekurit që ai do të gjejë, kur të shkojë pas varrimit në botën tjetër dhe i kërkojnë që t’i

përshëndesi në emrin e këtyre të gjallëve. Gjama fillon zakonisht me 10 burra, por deri sa ata afrohen vigut mund të vijnë e të shtohen edhe te tjerë. Në zonën e Malësisë së madhe ndryshon kjo mënyrë e vajtimit, sepse gjama bëhet vetëm me një gjamtar dhe bëhet edhe për gratë. Kjo vlen për tu theksuar, sepse ndër malesorët e malësisë së madhe, gruaja ka qenë e barabartë me burrin për nga vlera njerëzore. Kjo cilësi që tregon emancipimin e malë sorit më tepër se zonat rreth e qark në rang lokal dhe më gjerë. Ajo çka është për tu theksuar si më e përbashkëta e tyre thonë vetë gjamtarët t'ë shtë se: sa herë do nisja një gjamë apo ndryshe vajtim une vdisja shpirtërisht ndryshe gjama nuk bahej.

Veçoritë që duhet të ketë burri gjamtar

Gjamatarët ose vajatorët burra (sikurse edhe vajtoret femra), janë gjysmëprofesionistë dhe profesionistë. Vajatori bën gjamë për mashkullin e vdekur e jo për gruan. Ai duhet të ketë zë të lartë e të fortë. Në anën tjetër teksti duhet të jetë i tillë që t'ua lehtësojë dhe zvogëlojë dhimbjen dhe pikëllimin familjes dhe farefisit.

Gjama e burrave në malësi nuk ka një formësim të vargut konstant, por i ngjanë një tregimi të lirë. Janë pjesërisht të improvizuara. Veçoritë fonetike dhe shprehjet frazeologjike janë interesante: Thuhet për shembull "Mjer-o sot për ty Dak Kola", por edhe: "I mje-e-ri, o Mark Ukshini!", "O-ooo, i mjeri Gjeloosh Deda!", "I mjeee-ri, o Nikë Caku!".

Fig. – 5 Një nga elementët e qarjes me gjama të burrave në funeralin e Ujk Vuksanës (foto nga R. Schuz), v. 1936



Funerali i Ujk Vuksanit në Theth (foto: Reimer Schulz, 1937)

Ka edhe gjamë individuale (një burrë i vetëm), por kjo del si fenomen më i vonshëm, krahasim me gjamën kolektive. Gjamatari individual para se të thërras vaj, vë dy duart në brez duke nxjerrë njëren këmbë (në të shumtën e rasteve të majtën) përpara dhe ia fillon gjamës, duke theksuar ato virtyte e tipare që e kanë cilësuar për së gjalli të ndjerin, por edhe familjen e tij apo fisin. Gjamatari mund të thërrasë vajin te shtëpia vetëm në mëngjes. Natën nuk ka vajtores as gjamtarë te shtëpia e të vdekurit.

Gjama e Burrave të Dukagjinit në vdekjen e Skënderbeut

Tan kjo gjame ka dalë me za / Dielli drite s'po don me ba / Tok e Qiell po done me u da
 Se ka mete Leka pa vlla / I lumi un për ty o vlla / Shpata jote në tok pot kja
 Tan çka ka terri u ra / O i mjeri un per ty o vlla / Emrin Gjergj ta pat vu nana
 Lan sta kena për sulltana / Prej Stamollit rrug e gjatë / Fluturim tuj qit me shpatë
 Zjarm tuj qit si gjylja e motit / N' der të Kalas së Kastriotit. /Sot për ty ka ba gjam deti
 Ka shku fjala der te mreti / Diell e Hanë po derdhin lot / Tan mretnia gjam ka sot
 Të tanë prijsat në rrallë kanë ra / Se ka deke ma i miri vlla.

Piskama e malësorëve

Piskama e malësorëve mund të vlerësohet si një komunikim 'pa tel' që përçohet nga një majë mali te tjetra dhe prej andej, nëpër lugina, duke arritur që te banorët e çdo fshati, të japë lajmin përçdo gjë me rëndësi që

ata mendojnë se duhet bërë e njohur. Lulashi një prej rojeve tona, na shpjegoi se piskama bëhet gjithmonë sipas një kodi me pak fjalë, si p.sh: Heeeeeeeeeej, ‘si jeni ju andej?’, ose ‘na ka ardhur një mik’, ose ‘është vrrarë ose ka vdekur dikush’, ose ‘një familjeje të caktuar i ka lindur një djalë’. Ai na tha se zëri i malësorit, edhe nëse nuk i dallohen mirë fjalët, veç e veç, prapëseprapë është i dallueshëm si zë, sepse është i ndryshëm në varësi të lajmit që përhap dhe i kuptueshëm deri në pesë kilometra largësi në vijë ajrore. Piskama e malësorëve ka qenë po aq i shpejtë sa thirja me telefona sot, sepse shpejtësia e zerit e ndihmuar nga kalatë e shumta që shikonin e dëgjonin njera tjetrën dhe në pozicione si antenat e sotme ishin dhe përhapej aq shpejtë sa vetë ajo. Po kush popull tjetër e ka të trashëguar e të përcjellë këtë rit sa vetë populli shqiptar, jo nga koha e osmanit apo bizantit, por qysh para luftës së trojës, më sakt qysh me krijimin e kalave.⁷ Jo rastësisht, çdo fshat, (fshat i thënçin sot, sepse dikur ka qenë qytezë apo qytet) ka pasur një apo disa kala.⁸ Shikoni të dashur lexues, plan vendosjet e tyre, si p.sh., kalaja e petrelës, më tej e tiranës, pastaj e Prezës, pastaj e Krujës, më tej në Kurbin, Lezhë, Drisht, Shkodër dhe më tej në Mal të Zi sot, por në ilirinë e atherhme (malësia ilire) të cilat përfundojnë diku para alpeve të europës, se pas alpeve gjen burgje nëpër fusha.

PËRFUNDIME

1. Gjëma konsiderohet punë burrash, dhe prandaj ata që marrin pjesë duhet të jenë në një moshë të pjekur. Çdo fis apo fshat që vjen duhet të bëjë gjëmën e vet.
2. Në ditët e sotme, këto arsye duket se nuk qëndrojnë më, por si shpjegohet ekzistenca e këtij riti, dhe sa i fortë është ai ende sot?
3. “Pas ’90, ky rit është gjallëruar përsëri dhe vazhdon edhe sot, kryesisht në fshatra”, sqaron Martin Camaj. Nikollë Gjonpalaj është një nga ata njerëz që do të donin të përcilleshin për në banesën e fundit me gjëmë dhe e vuan zbehjen e kësaj tradite.⁹ Gjëma është traditë e fortë, por djemtë e ri përtojnë ta bëjnë - thotë Dom Nikolla.
4. Na duhet një gjegje, pse në veprën e Homerit, që 32 shekuj më parë, spikatin tipare pellazge të trashëguara, pikë për pikë, deri të shqiptarët e sotëm, si burrëria, besa, nderi, mikpritja, zemërbardhësia për dashamirin, urretja e pafund ndaj armikut, vëllamëria, ligjërimi i trimave me kujë dhe shkulje flokësh, e shumë të tjera. Po sjellim këtu një përjasje midis vajtimit të Akilit për bashkëluftëtarin dhe farefisin e vet Patroklin, dhe vajtimit të Lekë Dukagjinit për Gjergj Kastriotin, zakon tipikisht dhe vetëm e vetëm te pellazgët, ilirët dhe shqiptarët. “Lekë Dukagjini vrapoi te sheshi publik, ku, duke shqyer rrobat dhe duke shkukur flokët, sokëlliu me të madhe”.

⁷ Alber **OMON**, - ndër ta (shqiptarët), edhe sot janë në përdorim zakone të një kohe aq të vjetër, saqë vetëm në kohën homerike mund të gjenden”.

⁸ Sazan GURI - nuk duhet dyshuar që kalatë e shqipërisë së sotme e më gjerë janë tipikisht qytezat e para të qytetërimit pellazg; Janë të gjitha të një kohe (mijëvjeçari i tretë – dytë para krishtit), pamvarsisht se janë rrëzuar dhe ringritur në kohë të ndryshme, sipas pushtuesit të kohës; Janë të gjitha të ngritura mbi gurë ciklopik ose pellazgjik, sikundër kishat mbi ato bazilike dhe ato bazilike mbi ato pellazgjike (kisha në Dubrovnik, kisha e Kurjanit, Fier, etj.);

⁹ Vetë At Zef Pllumi në librin e tij ‘Rrno për me tregue’ ka treguar me kaq pasion se si e përjetoi ‘gjëmën e fundit’ në Malësi, pak pasi regjimi komunist kishte vendosur ndalimin.

5. Na duhet një gjegje, pse banorët e labërisë në Tepelenë i tregonin me kangë bëmat e Aleksandrit të Madh dhe pa gabime, dhe më vonë i dërguari i Bonapartit, Poukevili i gjeti po aq të vërteta në muzetë e Luvrit dhe të Londrës?
6. Na duhet një gjegje, pse dy zotat kryesorë, si Muji e Halili, (E.U = E.A - e ujit, M.Uji ≈ Mb'Uj dhe ENLIL ≈ ALIL ≈ HALILI) veprues në rrëfenjat Shumere janë po aq të pranishëm në Eposin Shqiptar të Kreshnikëve.
7. Qëllimi kryesor i gjëmës është shfryrja e dhimbjes dhe respektimi i figurës së të vdekurit. Por, në kohët kur mungonin mjetet e komunikimit, ajo shërbente dhe për të lajmëruar njoftimin e vdekjes.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Frano Bardhi, Fjalori Latinisht Shqip, v. 1635
2. Epii Gilgameshit, Tiranë, v. 1980, f. 79
3. Pjetër BUDI, Ritualit roman, v. 1621.
4. Ndër ta E. De Martino, M Eliade.
5. Fotot, si kjo dhe më poshtë janë bërë nga gjermani Raimer Shulc në Theth në vitin 1837. Fotot tregojnë se si ishte 'gjama e burrave' në atë kohë.
6. Etnologu Mark Tirta, v. 1637
7. Alber **OMON**, - ndër ta (shqiptarët), edhe sot janë në përdorim zakone të një kohe aq të vjetër, sa që vetëm në kohën homerike mund të gjenden".
8. Sazan GURI - nuk duhet dyshuar që kalatë e shqipërisë së sotme e më gjerë janë tipikisht qytezat e para të qytetërimit pellazg; Janë të gjitha të një kohe (mijëvjeçari i tretë – dytë para krishtit), pamvarsisht se janë rrëzuar dhe ringritur në kohë të ndryshme, sipas pushtuesit të kohës; Janë të gjitha të ngritura mbi gurë cikloplik ose pellazgjik, sikundër kishat mbi ato bazilike dhe ato bazilike mbi ato pellazgjike (kisha në Dubrovnik, kisha e Kurjanit, Fier, etj.);
9. Vetë At Zef Pllumi në librin e tij 'Rrno për me tregue' ka treguar me kaq pasion se si e përjetoi 'gjamën e fundit' në Malësi, pak pasi regjimi komunist kishte vendosur ndalimin.